

  
REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR VLORE

Nr regjistrimit 105  
Date regj. 29.01.2014

Nr 105 61-2014-551 Vendimit  
Data 24.02.2014

**VENDIM**  
**"Ne Emer te Republikes"**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perbere nga:

**GJYQTAR - ARQILE BASHO**

Asistuar prej sekretares Luljeta Kollombo,  
Me pjesmarrjen e prokurorit Skender Dautaj,  
Ne gjykate, sot ne date 24.02.2014, ne shqyrtimin e ceshtjes me Nr 105 Akti  
qe i perket:

**KERKUES:** [REDAKTUAR], I biri [REDAKTUAR], dt/l 14.01.1959, lindur  
dhe banues ne Vlore.

**OBJEKTI:** Heqjen e sekuestros se automjetit tip Audi me targ [REDAKTUAR]

**Baza Ligjore:** Nenet 274/3 dhe 275/2 te Kodit Procedures Penale.

Gjykata, ne séance gjyqesore, pasi konstatoi mungesen e kerkuesit dhe te mbrojtetit, si dhe pasi mori mendimin e prokurorit pjesemarrës

**V E R E N**

Ne emer te kerkuesit [REDAKTUAR], eshte parashtruar ne gjykate kerkesa me  
object "heqjen e sekuestros se automjetit tip Audi me targ [REDAKTUAR]"

**Nga shqyrtimi gjyqesor i kerkeses rezultoi se:**

Gjykata ka proceduar me shqyrtimin e kerkeses duke thirrur kerkuesin ne adresen e mbrojtetit qe ka perpiluar kerkesen, sipas porosise ne aktin e kerkeses, ne rrethanat kur kerkesa nuk permbante adresen e kerkuesit.

Ne seancen gjyqesore dt 24.02.2014, nuk eshte paraqitur as kerkuesi dhe as mbrojtasi qe ka perpiluar kerkesen ne emer te kerkuesit.

Gjykata konstaton se kerkesa e parashtruar prane saj nuk eshte nenshkruar nga kerkuesi, nuk permban adresen e tij, nuk permban prova qe lidhen me permbajtjen e kerkimit.

**Ne keto rrethana dhe mbi percaktimin e Ligjit gjykata vlereson se:**

Ne rrethanat e rastit konkret procedimi penal per shqyrtimin e kerkeses se parashtruar nga kerkuesi, ka filluar me parashtrimin e nje akti te kerkeses ne emer te tij, te redaktuar nga nje mbrojtës, akti i kerkeses nuk eshte nenshkruar nga kerkuesi, nuk permban Prokuren e perfaqesimit per avokatin si dhe nuk i eshte bashkengjitur asnje prove qe lidhet me rrethanat e kerkimit.

Ne keto Gjykata vlereson se kerkesa nuk eshte e autorizuar nga kerkuesi fakt qe provohet me mungesen e nenshkrimin prej tij, mungesen e adreses se tij dhe mungesen e aktit te perfaqesimit per mbrojtësin.

Gjykata procedoi gjykimin e kerkeses duke thirrur mbrojtësin me qellim sqarimin e rrethanave dhe paraqitjen e aktit te perfaqesimit, por mbrojtësi me aktivitet aktualisht prane kesaj gjykate nuk u paraqit.

Neni 290 K.Pr.Penale percakton: *"1. procedimi penal nuk mund te filloje dhe ne qofte se ka filluar duhet te pushojë ne cdo gjendje te procedimit, kur: .... c) mungon ankimi i të demtuarit ose ai e terheq ankimin ....e) ne te gjitha rastet e tjera te parashikuara nga ligji."*

Neni 387 K.Pr.Penale percakton: *Vendimi i pushimit të çështjes*

*1. Kur ndjekja penale nuk duhet të fillonte ose nuk duhet të vazhdojë, ose kur vepra penale është shuar, gjykata vendos pushimin e çështjes, duke treguar edhe shkakun.*

*2. Gjykata vendos në të njëjtën mënyrë kur ekzistenca e një kushti procedimi apo e një shkakut që shuan veprën penale është e dyshimtë.*

Ne rrethanat e rastit konkret gjykata vlereson se ne kerkesen e parashtruar me object "heqjen e sekuestros se automjetit tip Audi me targa [redacted] mungon ankimi i te demtuarit. Kerkesa eshte parashtruar nga nje person qe nuk ka autorizimin e te demtuarit nga sekuestrimi dhe pa dijenine e tij. Kryerja personalisht apo dhenia e autorizimit per parashtrimin e kerkeses ne gjykate jane kusht i domosdoshem i parashikuara ne neni 274 te K.Pr.Penal qe parashikon disponimin e gjykates mbi sekuestron e vendosur "me kerkesen e te interesuarit".

Perfundimisht gjykata konkludon se, ne rastin konkret, procedimi per gjykimin e kerkeses duhet te pushohet per shkak se mungon "ankimi i te



demtuarit" dhe per shkak se kushti i procedimit - paraqitja e nje kerkese ne emer te kerkuesit eshte e dyshimte.

PER KETO ARSYE

Gjykata ne baze te nenit 290I/c dhe 387 te K.Pr.Penale

VENDOSI

Pushimin e gjykimit te ceshtjes penale me Nr 105 Akti qe i perket:

"Kerkues: ██████████"

Objekti: Heqjen e sekuestros se automjetit tip Audi me targa ██████████"

- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen avokati ██████████
- Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 10 diteve nga e nesermja e shpalljes.

U shpall ne Vlore me 24.02.2014

SEKRETARE  
Luljeta Kollombo

GJYQATAR  
Arqile BASHO

Shpenzime gjyqesore

Shpenzime kancelarike 100 leke  
Shpenzime per njoftim 200 leke  
Shuma 300 leke

VENDEMI MORI FORME TE PRERE  
PASI NUK U ANKIMUA  
me date 10.03.2014  
K/SEKRETARE  
REZARTA TAUSHANI

*[Handwritten signature]*  
*[Handwritten signature]*  
*[Handwritten signature]*